

ANEKSI 6

Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore

1. Fondi për **Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** është një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore e të tjera.
2. Për vitin 2023, Fondi për **Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** përbëhet nga fondi i akorduar në buxhetin e vitit 2023 në programin “Emergjencat Civile”, në Ministrinë e Mbrojtjes.
3. Vlerësimi i projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore aplikuese bëhet me vendim të Komisionit për **Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore**, i cili kryesohet nga Drejtori i AKMC - Kryetar dhe ka në përbërje anëtarë nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile), anëtarë nga Ministria e Mbrojtjes dhe anëtarë nga Shoqata për Autonomi Vendore.
4. Komisioni për **Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** miraton; specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve në infrastrukturë dhe për blerje pajisjesh për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore si dhe vlerësimin e projekteve.
5. Sekretariati teknik për Fondin e Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore ngrihet pranë AKMC.
6. Fondi i **Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore** me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime midis projekteve të Fondit të **Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore**, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
7. Thirrjet për aplikim në Fondin **Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore** për vitin buxhetor 2023, mund të bëhen që në nëntor të vitit paraardhës deri në 31 Janar të vitit korent.
8. Projektet e përzgjedhura nga Ministria e Mbrojtjes (Komisioni për **Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore**) dërgohen pranë Këshillit të Ministrave brenda datës 15 Shkurt të vitit korent.
9. Këshilli i Ministrave miraton projektet fituese, si dhe autoritetin kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore brenda datës 28 Shkurt të vitit korent.
10. Fondi i **Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore** nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.
11. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.